Shtojca 8: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlere absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Furnizim vendosje kaldaja me naftë në objektet publike në menaxhim nga DPOP				
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia	Afati i lëvrimin të pajisjeve
1	F.V. Kaldaje N = 350 Kw + PANEL KONTROLI	copë	6	3 muaj
2	F.V. Kaldaje N = 450 Kw + PANEL KONTROLI	copë	3	3 muaj
3	F.V. Kaldaje N = 550 Kw + PANEL KONTROLI	copë	1	3 muaj
4	F.V Ene zgjerimi 500 litra per kaldaje	copë	4	3 muaj
5	F.V Ene zgjerimi 300 litra per kaldaje	copë	2	3 muaj
6	F.V Ene zgjerimi 200 litra per kaldaje	copë	4	3 muaj

7	F.V Djeges nga 142-355 KW	copë	6	3 muaj
8	F.V Djeges nga 237-630 KW	copë	4	3 muaj
9	F.V. Saraçineska dalje $\phi 1\frac{1}{2}$ per tuba celiku, e taruar. Presioni max 10 bar. Temperatura 5-100 °C	copë	70	3 muaj
10	F.V. Saraçineska dalje $\phi 2$ " per tuba celiku, e taruar. Presioni max 10 bar. Temperatura 5-100 °C	copë	20	3 muaj
11	F.V. Radiator 1800 Kcal/h (h=600mm)	copë	8	3 muaj
12	F.V. Radiator 2800 Kcal/h (h=600mm)	copë	22	3 muaj
13	F.V. Radiator 3400 Kcal/h (h=600mm)	copë	20	3 muaj
14	F.V. Radiator 3900 Kcal/h (h=600mm)	copë	8	3 muaj
15	F.v. Saraçineska dalje (radiatori) per tuba celiku,e taruar.	copë	116	3 muaj
16	F.V. pompe teke qarkulluese per funksionimin e kaldajes me prurje 8.400lt/h	copë	2	3 muaj
17	F.V. pompe teke qarkulluese per funksionimin e kaldajes me prurje 12.600lt/h	copë	4	3 muaj
18	F.V. pompe teke qarkulluese per funksionimin e kaldajes me prurje 16.300lt/h	copë	4	3 muaj
19	F.V. Impianti Kontrollit dhe monitorimit DMD (DIAGNOSTIC MONITORING DEVICE) per kryerjen e monitorimit, kontrollit dhe diagnostikimit ne distance te kaldajave.	copë	10	3 muaj
20	CMONTIM - i kaldajave egzistuese dhe i elementeve funksional te cilet nuk eshte e mundur te perdoren ne sistemin e ri	copë	10	3 muaj
21	TRANSPORT - i kaldajave egzistuese dhe i elementeve funksional te cilet nuk eshte e mundur te perdoren ne sistemin e ri	copë	10	3 muaj

Lista e objekteve ku do instalohen kaldajat:

Nr.	Emertimi i objektit
1	Shkolla 9 vjecare Vasil Shanto
2	Gjimnazi Sadik Stavaleci
3	Shkolla 9 vjecare Mëzes Fushe
4	Shkolla 9 vjecare Ardian Klosi
5	Gjimnazi Ibrahim Brahja
6	Shkolla 9 vjecare Bajram Curri
7	Shkolla 9 vjecare Osman Myderizi
8	Shkolla 9 vjecare Skender Caci
9	Shkolla 9 vjecare Ramazan Jarani
10	Shkolla 9 vjecare Drita Pelinku

SPECIFIKIMET TEKNIKE

F.V. KALDAJË ME Th 300 =350 KW (të përzgjedhshme) me naftë

Kaldaja duhet të jetë me fuqi jo më të vogël se 350 KW ose fuqi kalorifike 300 Mcal/h. Kaldaja të jete e pajisur me djegësin (nje fazor).

Përshkrimi: Kaldaja duhet të ketë një konstruksion solid, të kursejë energji dhe të ketë mundësi hapje të derës si nga krahui i majtë dhe i djathtë, të ketë mundësi mirëmbajtje sa më praktike. rendimenti të jetë $\geq 95\%$, të sigurojë temperaturë ngrohje uniforme, të jetë sa më silencioz..

Kaldaja shoqërohet me një panel kontrolli i pajisur me të gjithë instrumentat e nevojshëm: çelësi kryesor, termostatët e sigurisë, termostatët e djegësit, termostatët e pompës së ujit, termometër, llamapat sinjalizuese. **(Garancia 3 (tre) vjet)**

F.V. KALDAJË ME Th 450 kW (të përzgjedhshme) me naftë

Kaldaja duhet të jetë me fuqi jo më të vogël se 450 kW ose fuqi kalorifike 400 Mcal/h. Kaldaja të jetë e pajisur me djegësin (një fazor).

Përshkrimi: Kaldaja duhet të ketë një konstruksion solid, të kursejë energji dhe të ketë mundësi hapje të derës si nga krahui i majtë dhe i djathtë, të ketë mundësi mirëmbajtje sa më praktike, rendimenti të jetë $\geq 95\%$, të sigurojë temperaturë ngrohje uniforme, të jetë sa më silencioz.

Kaldaja shoqërohet me një panel kontrolli i pajisur me të gjithë instrumentat e nevojshëm: çelësi kryesor, termostatët e sigurisë, termostatët e djegësit, termostatët e pompës së ujit, termometer, llamapat sinjalizuese. **(Garancia 3 (tre) vjet)**

F.V. KALDAJË ME Th 500 = 580 kW (të përzgjedhshme) me naftë

Kaldaja duhet të jetë me fuqi jo më të vogël se 580 kW ose fuqi kalorifike 500 Mcal/h. Kaldaja të jetë e pajisur me djegësin (një fazor).

Përshkrimi: Kaldaja duhet të ketë një konstruksion solid, të kursejë energji dhe të ketë mundësi hapje të derës si nga krahui i majtë dhe i djathtë, të ketë mundësi mirëmbajtje sa më praktike, rendimenti të jetë $\geq 95\%$, të sigurojë temperaturë ngrohje uniforme, të jetë sa më silencioz.

Kaldaja shoqërohet me një panel kontrolli i pajisur me të gjithë instrumentat e nevojshëm: çelësi kryesor, termostatët e sigurisë, termostatët e djegësit, termostatët e pompës së ujit, termometer, llamapat sinjalizuese. **(Garancia 3 (tre) vjet)**

F.V. DJEGËS nga 142-355 KW

Djegësi (një fazor) duhet të ketë një diapazon diegie nga 142-355KW, mënyra e operimit duhet të jetë me nje fazë; - Trup alumini; - Mbulim mbrojtës me një shtresë mbrojtëse asorbuese e zhurmës; - Flakëhedhësi me rregullim mikrometrik me performancë të lartë dhe qëndrueshmëri e flakës; - Dimensione jashtëzakonisht kompakte.

Djegësi duhet të jetë i pajisur me një panel kontrolli me mikro procesor i cili jep në kohë reale të dhënat e djegësit si dhe sinjalizimet për difekte të ndryshme. **(Garancia 3 (tre) vjet)**

F.V. DJEGËS nga 237-630 KW

Djegësi (nje fazor) duhet të ketë një diapazon djegie nga 237-630 KW, mënyra e operimit duhet të jetë me dy faza; - Trup alumini; - Mbulim mbrojtës me nje shtrese mbrojtese asorbuese e zhurmes; - Flakëdhësi me rregullim mikrometrik me performancë të lartë dhe qëndrueshmëri e flakës; - Dimensione jashtëzakonisht kompakte.

Djegësi duhet të jetë i pajisur me një panel kontrolli me mikro procesor i cili jep në kohë reale të dhënat e djegësit si dhe sinjalizimet për difekte të ndryshme. **(Garancia 3 (tre) vjet)**

F.V. Enë zgjerimi 500 litra

Enë zgjerimi për sistem kaldaje 500 litra me presion 6 bar për përdorim në sisteme qendrore të ngrohjes dhe ftohjes. Presioni maksimal i punës 6 bar , volumi 500 litër temperatura e punës -10 °C - +100°C.
(Garancia 3 (tre) vjet)

F.V. Enë zgjerimi 200 litra

Enë zgjerimi për sistem kaldaje 200 litra me presion 6 bar për përdorim në sisteme qendrore të ngrohjes dhe ftohjes. Presioni maksimal i punës 6 bar , volumi 200 litër temperatura e punës -10 °C - +100°C.
(Garancia 3 (tre) vjet)

F.V. Ene zgjerimi 300 litra

Ene zgjerimi per sistemi kaldaje 300 litra me presion 6 bar per perdorim ne sisteme qendrore te ngrohjes dhe ftohjes. Presioni maksimal i punes 6 bar , volumi 300 liter temperatura e punes -10 °C - +100°C.
(Garancia 3 (tre) vjet)

F.V. Radiator

Te jene sipas standardit EN 442-1,2,3 , Temperatura maksimale 12°C dhe lidhjet hidraulike me dimension 1/2". Dimensionet referuese te perzgjedhshme: 600x1200 mm dhe gjeresi 100 mm me kapacitet kalorifik jo me pak se 1800 Kcal/h . **(Garancia 3 (tre) vjet)**

F.V. Radiator

Te jene sipas standardit EN 442-1,2,3 , Temperatura maksimale 110°C dhe lidhjet hidraulike me dimension 1/2". Dimensionet referuese te perzgjedhshme :600x1400 mm dhe gjeresi 150 mm me kapacitet kalorifik jo me pak se 2800 Kcal/h . **(Garancia 3 (tre) vjet)**

F.V. Radiator

Te jene sipas standardit EN 442-1,2,3 Temperatura maksimale 110°C dhe lidhjet hidraulike me dimension 1/2". Dimensionet referuesete perzgjedhshme :600 x 1800 mm dhe gjeresi 150 mm me kapacitet kalorifik jo me pak se 3400 Kcal/h . **(Garancia 3 (tre) vjet)**

F.V. Radiator

Te jene sipas standardit EN 442-1,2,3 Temperatura maksimale 110°C dhe lidhjet hidraulike me dimension 1/2". Dimensionet referuese te perzgjedhshme. Kapacitet kalorifik jo me pak se 3900Kcal/h , dimensionet referuese : 800x2000 dhe gjeresi 150mm. **(Garancia 3 (tre) vjet)**

F.V. Pompe qarkulluese

Pompë qarkulluese me tre shpejtësi e projektuar për sistemet e ngrohjes dhe ajrit të kondicionuar ne sistemet e ngrohjes qendrore. Pompa siguron funksionim të besueshëm dhe pa mirëmbajtje Prurja 8.400 lt/h., **(Garancia 3 (tre) vjet)**

F.V. Pompe qarkulluese

Pompë qarkulluese me tre shpejtësi e projektuar për sistemet e ngrohjes dhe ajrit të kondicionuar ne sistemet e ngrohjes qendrore. Pompa siguron funksionim të besueshëm dhe pa mirëmbajtje Prurja 12.600 lt/h., **(Garancia 3 (tre) vjet)**

F.V. Pompe qarkulluese

Pompë qarkulluese me tre shpejtësi e projektuar për sistemet e ngrohjes dhe ajrit të kondicionuar ne sistemet e ngrohjes qendrore. Pompa siguron funksionim të besueshëm dhe pa mirëmbajtje Prurja 16.300 lt/h., **(Garancia 3 (tre) vjet)**

F.V. Impianti Kontrollit dhe monitorimit DMD (DIAGNOSTIC MONITORING DEVICE) per kryerjen e monitorimit, kontrollit dhe diagnostikimit ne distance te kaldajave.

Nepermjet instalimit te sistemit te monitorimit dhe kontrollit ne distance te behet diagnostikimi, menaxhimi, automatizimi i sistemit termo-hidraulik, te behet kontrolli i gjendjes së manometrave të presionit, të termostateve, paneleve elektrike- elektronike.

Sistemi duhet te përmbushë kërkesat sipas standardit evropian UNI EN 15232 për klasifikimin e energjisë maksimale. Standardi EN 15232 përcakton ndikimin e automatizimit të ndërtesës në performancën energjetike të ndërtesave dhe është i vlefshëm si për ato ekzistuese ashtu edhe për ato në fazën e projektimit ose rindërtimit. Kuadri ligjor perkates parashikon që institucionet shtetërore dhe operatorët duhet të zbatojnë eficiencen energjitike ne performancen e ndërtesave. Ky sistem bazohet per Kontrollimin dhe monitorimin DMD (Diagnostic Monitoring Device), i cili theksojmë se është shërbim në funksion të mirëmbajtjes së sistemeve ngrohje – ftohje. Ofrim shërbimi i për ta arritur nje efekt të mirëmbajtjes sa më efikase të sistemeve ngrohje – ftohje, duke monitoruar, kontrolluar dhe diagnostifikuar punën e sistemeve ngrohje – ftohje duke bërë të mundur parandalimin e defekteve me anë të diagnostifikimit.

1) Impianti i monitorimit dhe controllit ne distance (Central me kaldaje me nafte)

Sistemi	Bojler me nafte ndezja e të cilit kontrollohet me një kontakt.
Termostati ne Ambient	Te lexohet temperatura me sondën e dergimit (variabel i manipuluar).
Termostati Jashtem	Te lexohet temperatura me sondën e vendosur jasht ambientit te godines.
Rrjeti Kryesor	Te lexohet temperatura me sondën e vendosur ne rrjetin e qarkullimit ne qarkun kryesor C1 (variabel).
Rrjeti i brendshem nr. I	Te lexohet temperatura me sondën e vendosur ne rrjetin e qarkullimit kati I (variabel).
Rrjeti i brendshem nr. I	Te lexohet temperatura me sondën e vendosur ne ambient kati I (variabel kontrolli).

Rrjeti i brendshem nr. I	Te lexohet kontakti i kontrollit të pompës së qarkut C2.
Rrjeti i brendshem nr. II	Te lexohet temperatura me sondën e vendosur ne rrjetin e qarkullimit kati II (variabel).
Rrjeti i brendshem nr. II	Te lexohet temperatura me sondën e vendosur ne ambient kati II (variabel kontrolli).
Rrjeti i brendshem nr. II	Te lexohet kontakti i kontrollit të pompës së qarkut C3.
Rrjeti i brendshem nr. III	Te lexohet t temperatura me sondën e vendosur ne rrjetin e qarkullimit kati III (variabel).
Rrjeti i brendshem nr. III	Te lexohet temperatura me sondën e vendosur ne ambient kati III (variabel kontrolli).
Rrjeti i brendshem nr. III	Te lexohet kontakti i kontrollit të pompës së qarkut C3.
Compiuter Kontrolli	Kerkohet kompiuter Master dhe ndihmes per totale 12 sonda per te realizuar skemen e funksionimit.

Kontrolli dhe monitorimi Klasifikimi

BACS EFFICIENCY		i sistemit BACS (Building Automation and Control Systems)
A:	high energy efficiency BACS and BMS systems	
B:	advanced BACS and BMS (Building Management System) systems	

Sistemi DMD

DIAGNOSTIC MONITORING DEVICE

Pajisja

Te jete PLC me porten Modbus dhe një server në internet i pajisur me një dhenes/transmetues të dhënash.

Sistemi i monitorimit

Te krijoje mundesine e regjistrimit te vlerave te 8-12 variablave me një kampionim në minutë. Të dhënat e regjistruara në server janë mesatarja e vlerave të të dhënave të regjistruara në minutë. Të dhënat te mund të shihen përmes përdorimit të një programi grafik që gjithashtu lejon mbivendosjen e 4 variablave të zgjedhur nga 8-12 të gjurmuar. Të dhënat e variablave që do të vizatohen janë zgjedhje të lira, të zgjedhura në një bazë më të madhe se 500 sasi të pranishme në programin PLC. Përmes platformës DMD, stafi teknik te jete në gjendje të kryejë në mënyrë autonome vlerësime mbi gjendjen e funksionimit të sistemit dhe te mund të ketë qasje në konsultimin e të dhënave deri në 3 ditët e mëparshme. Ai gjithashtu kerkohet te mund të kontrollojë statusin e ndezjes së Pajisjeve Kryesore dhe të zbulojë mosfunksionimet. Në kohë reale, 30 variabla të për zgjedhur nga një listë e përgjithshme e të dhënave më të mëdha se 500 te jene në dispozicion. Vonesa maksimale që mund të ndodhë është rreth 3 sekonda dhe varet ekskluzivisht nga

	rrjeti i internetit i pranishëm. Për funksionimin e duhur të Sistemit, duhet të garantohet një furnizim elektrik me një luhatje të tensionit prej 8% dhe një UPS të fuqizuar në mënyrë adekuate. Për të ruajtur përbërësit e hardwerit, është e nevojshme të sigurohet mbrojtje kundër shkarkimeve elektrike të shkaktuara nga rrufeja. Sistemi i monitorimit DMD duhet të sigurojë një shërbim DISTANCE të mbështetjes teknike gjatë fazës së instalimit të pajisjeve. Asistenca ofrohet për zgjidhjen e mosfunksionimeve ose problemeve për sa kohë që ato kanë të bëjnë ekskluzivisht me sistemin e furnizuar, prandaj çdo konsulencë dhe/ose aktivitet tjetër që i atribuohet gabimeve ose neglizhencës gjatë fazës së instalimit, problemeve teknike në lidhje me vendin e impiantit përjashtohet. Dhe për çdo faktor tjetër jashtë Sistemit që mund të përjashtojë ose kufizojë përdorimin e tij.
Menaxhimit të ndërtesës (TBM)	Sistemeve inteligjente të diagnostikimit dhe menaxhimit të sistemit termo-hidraulik. Sistemi duhet të përmbushë kërkesat sipas standardit evropian UNI EN 15232 për klasifikimin e energjisë maksimale. Standardi EN 15232 përcakton ndikimin e automatizimit të ndërtesës në performancën energjetike të ndërtesave dhe është i vlefshëm si për ato ekzistuese ashtu edhe për ato në fazën e projektimit ose rindërtimit. Kuadri ligjor perkates parashikon që institucionet shtetërore dhe operatorët duhet të zbatojnë eficiencën energjetike në performancën e ndërtesave.
Plan kontrolli të strukturuar	Përfshin funksionet e automatizimit të ndërtesave dhe menaxhimin teknik të tyre me ndikim në performancën e energjisë;
Metodë	Përcaktimin e kërkesave minimale që do të zbatohen në ndërtesa me kompleksitet të ndryshëm ose në ndërtesa me rëndësi të veçantë. Vlerësimin e ndikimit dhe përcaktimin e treguesve sipas prEN-15203 dhe PrEN-15217;
Vlerësim fillestar	Metodë e thjeshtë për të dhënë një vlerësim fillestar të ndikimit të automatizimit në një lloj të caktuar ndërtese.
Testimi dhe rregullimi dinamik	Metodë e thjeshtë për të dhënë një vlerësim fillestar të ndikimit të automatizimit në një lloj të caktuar ndërtese.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	F.V. Kaldaje N = 350 Kw + PANEL KONTROLI	6	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
2	F.V. Kaldaje N = 450 Kw + PANEL KONTROLI	3	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
3	F.V. Kaldaje N = 550 Kw + PANEL KONTROLI	1	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
4	F.V Ene zgjerimi 500 litra per kaldaje	4	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
5	F.V Ene zgjerimi 300 litra per kaldaje	2	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
6	F.V Ene zgjerimi 200 litra per kaldaje	4	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
7	F.V Djeges nga 142-355 KW	6	Në objektet publike arsimore në	3 muaj

			menaxhim nga DPOP	
8	F.V Djeges nga 237-630 KW	4	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
9	F.V. Saraçineska dalje $\phi 1\frac{1}{2}$ per tuba celiku, e taruar. Presioni max 10 bar. Temperatura 5-100 °C	70	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
10	F.V. Saraçineska dalje $\phi 2$ " per tuba celiku, e taruar. Presioni max 10 bar. Temperatura 5-100 °C	20	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
11	F.V. Radiator 1800 Kcal/h (h=600mm)	8	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
12	F.V. Radiator 2800 Kcal/h (h=600mm)	22	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
13	F.V. Radiator 3400 Kcal/h (h=600mm)	20	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
14	F.V. Radiator 3900 Kcal/h (h=600mm)	8	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
15	F.v. Saraçineska dalje (radiatori) per tuba celiku,e taruar.	116	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj

16	F.V. pompe teke qarkulluese per funksionimin e kaldajes me prurje 8.400lt/h	2	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
17	F.V. pompe teke qarkulluese per funksionimin e kaldajes me prurje 12.600lt/h	4	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
18	F.V. pompe teke qarkulluese per funksionimin e kaldajes me prurje 16.300lt/h	4	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
19	F.V. Impianti Kontrollit dhe monitorimit DMD (DIAGNOSTIC MONITORING DEVICE) per kryerjen e monitorimit, kontrollit dhe diagnostikimit ne distance te kaldajave.	10	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
20	CMONTIM - i kaldajave egzistuese dhe i elementeve funksional te cilet nuk eshte e mundur te perdoren ne sistemin e ri	10	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj
21	TRANSPORT - i kaldajave egzistuese dhe i elementeve funksional te cilet nuk eshte e mundur te perdoren ne sistemin e ri	10	Në objektet publike arsimore në menaxhim nga DPOP	3 muaj

Afatet e lëvrimit: Brenda 3 (tre) muajve nga data e nënshkrimit të kontratës

Garancia e pajisjeve 3 (tre) vjet

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçencë profesionale të shoqërisë**, të lëshuar nga institucioni përgjegjës i ngarkuar me ligj, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, ku të përfshihen të paktën **kategoritë** e mëposhtme:

a) NS-12A (Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit)

2.1.3 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- SSH/EN/ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) “ose ekuivalent; (të vlefshme) ose ekuivalentet e tij të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.

-
- SSH/EN/ ISO 45001-2018 mbi “Sistemin e menaxhimit dhe sigurise ne pune” ose ekuivalent;
 - SSH/EN/ ISO 27001-2013 mbi “Sistemin e menaxhimit të informacionit” ose ekuivalent;
 - SSH/EN/ ISO 20000-1:2018 mbi “Sistemin e menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit” ose ekuivalent;

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 te secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marrë përsipër te realizojë sipas aktmarrëveshjes.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik për këtë objekt prokurimi, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, ***të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën tre muajt e fundit, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:***

- Licencë për Drejtues Teknik
- Diplomë
- Kontratë pune e vlefshme

Në rastin e bashkimit të operatorëve secili operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 11 (njëmbëdhjetë) punonjës të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën tre muajt e fundit në listpagesat përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklaramit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të

paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

2.3.4 Operatori ekonomik për zbatimin e kësaj kontrate duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik për instalimin e sistemeve në fushën objekt prokurimi, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë periudhën 3 (tre)ajt e fundit, sipas profileve te meposhtme:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Elektronik

Në fazën e ofertimit, për punonjësit, të plotësohet në vetëdeklarimin sipas Shtojcës 9, ndërsa në rast të kualifikimit, përpara shpalljes së fituesit paraprak, duhet të paraqiten dokumentat Diplomë dhe kontratë pune.

2.3.5 Operatori ekonomik për zbatimin e kësaj kontrate duhet të ketë të punësuar staf teknik për instalimin e sistemeve në fushën objekt prokurimi, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë periudhën tre muajt e fundit, sipas profileve te meposhtme:

- 3 (tre) Specialist per sistemet ngrohje/ftohje
- 1 (një) Elektriçist
- 3 (tre) Specialistë IT të diplomuar në informatike, etj.

a) Diplomë/Certifikatë/ Dëshmi për kualifikimin/ trajnimin.

b) Kontratat individuale të Punës vlefshme në kohën e zhvillimit te procedurës.

c) Listëpagesat e deklaruara të punonjësve, sipas formatit E-Sig 025/a, për periudhën tre muajt e fundit, të konfirmuara nga administrata tatimore.

d) Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të lëshuar nga administrata tatimore, për periudhën tre muajt e fundit.

Në fazën e ofertimit, për punonjësit, të plotësohet në vetëdeklarimin sipas Shtojcës 9, ndërsa në rast të kualifikimit, përpara shpalljes së fituesit paraprak, duhet të paraqiten dokumentat.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Shënim:

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK.

2.3.6 OE duhet te paraqese deklarate garancie 36 muaj per mallrat te furnizuar.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim nga kompania prodhuese e mallrave ose nga Distributori i Autorizuar nga prodhuesi (distributori duhet te jete i autorizuar per territorin e Shqiperise) lidhur me tregtimin e artikujve te ofruar (kaldata, djeges, ene zgjerimi, sistemi DMD). Ne rastin e distributorit te autorizuar te provohet lidhja me prodhuesin nepermjet dokumentacionit perkates.

2.3.8 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për artikujt e ofruar (kaldaja, djeges, ene zgjerimi). Në katalogë, të përfshihen specifikimet teknike (*pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhen shqipe, të perkthehen në gjuhen shqipe dhe të noterizohen*). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun perkates produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të percaktuar në formularin e ofertes. Kataloget do pranohen vetëm në formë elektronike nepermjet sistemit elektronik të prokurimit www.app.gov.al.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” , I ndryshuar, “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në rastet e dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur,

3. “Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
